



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1283/ Prot.

Tiranë, më 13.08.2025

VENDIM
Nr. 89, datë 6.5.2025

PËR

“FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATIN QË KA KANDIDUAR PËR T’U RIEMËRUAR NË POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, ZOTIT ARENS ÇELA”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar (në mungesë)

në mbledhjen e datës 06.05.2025, bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës, nenet 159, pika 2, germa “a” dhe “e”, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 32 dhe 52 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë të Prokurorisë, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për tu riemëruar në pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, zotit Arens Çela”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Mbasi shqyrtoi relacionin shoqërues të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, dëgjoi relatorin zoti Erind Merkuri, si edhe diskutoi çështjen në tërësi,



KOPJE WEB



VËREN:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin e tij, nr. 264, datë 11.10.2022, e ka caktuar zotin Arens Çela si Drejtues (Kryetar) të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, për një mandat 3 vjeçar. Ky mandat përfundon me datë 10.10.2025.
2. Ligji nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, në nenin 52, pika 2 të tij parashikon se *“Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë”*. Bazuar në këtë parashikim ligjor, rezulton se zoti Arens Çela, nëpërmjet shkresës nr. 8519 prot., datë 3.4.2025, protokolluar në Këshill, nr. 1124 prot., datë 03.04.2025, ka shprehur vullnetin për të kandiduar për një mandat të dytë. Kjo kërkesë rezulton që të jetë paraqitur brenda afatit të parashikuar nga dispozita ligjore.
3. Dispozita më tej, në pikat 3 dhe 4 parashikon se: *“3. Kur kryetari në detyrë kandidon për riemërim, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli përkatës, jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të parashikuara në pikat nga 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 4. Kryetari riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji, dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën “shumë mirë”*”.
4. Për këtë arsye, për ndjekjen e këtyre hapave ligjorë, Këshilli duhet të vijojë me fillimin e procedurave për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka rikandiduar për pozicion drejtuesi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
5. Për lejimin e kandidatit prokuror në vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë është i domosdoshëm kalimi me sukses i procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, bazuar në informacionin e ardhur nga institucionet e tjera shtetërore. Ky proces realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, i mbështetur nga Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
6. Ky verifikim përfshin periudhën nga deklarimi i fundit i kandidatit zoti Arens Çela të bërë në kandidimin për mandatit e tij të parë në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
7. Sipas dispozitave ligjore, Kryetari (Drejtuesi) riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin, dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën “shumë mirë”.
8. Mbështetur në nenin 161, të ligjit 115/2015 , *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, Këshilli zhvillon procedurë shortimi për caktimin e relatorit.
9. Nga procedura e brendshme e ndjekur nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, rezulton se Kryetari i këtij Komisioni ka paraqitur heqjen



KOPJE WEB



dorë nga kjo procedurë e cila është pranuar nga ana e Kryetares së Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për këtë arsye, në Komision ka marrë pjesë si anëtar zëvendësues zoti Vatë Staka.

10. Bazuar në Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, (Miratuar me vendimin nr.407, datë 17.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë) neni 35, pika 5, u hodh shorti midis dy anëtarëve të përhershëm duke u përcaktuar si Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale për këtë procedurë e zotit Erind Merkuri.

11. Për këto arsye, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, që do të ndjekë këtë procedurë përbëhet tashmë nga Erind Merkuri (Kryetar) dhe anëtarë zotit Olger Eminaj dhe zotit Vatë Staka. Për rrjedhojë, në rastin e kësaj procedurë shorti, për caktimin e relatorit që do të ndjekë procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës u zhvilluar ndërmjet këtyre anëtarëve.

12. Ky verifikim realizohet dhe bashkërendohet me informacionin që do të vijë nga institucionet e tjera shtetërore, kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroritë, organet e administratës tatimore dhe doganore, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Sipas ligjit, nëse është e nevojshme, Këshilli mund të kërkojë informacion shtesë nga institucionet e përmendura më sipër.

13. Në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshilli do të vendosë lejin e kandidatit prokuror dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë (rikandidimin) ose ndalimin e kandidatit prokuror dhe përjashtimin e tij nga procedura e ngritjes në detyrë (rikandidimin).

PËR KËTO ARSYE:

bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2, germa “a” dhe “e”, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenet 32 dhe 52 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për tu riemëruar në pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, zotit Arens Çela.
2. Caktimin në bazë të shortit të zotit Erind Merkuri si relator për këtë procedurë.
3. Ky vendim hyn në fuqi, me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe i njoftohet zotit Arens Çela.

U shpall në Tiranë, sot më 6.5.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdan

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Erind Merkuri

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Vatë Staka